REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HIMARE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com

Nr.5821 Prot.

Himare me 29/12/2016

VENDIM
Nr. 88 date 28.12.2016

Per miratimin e ndryshimit te emrit te Shoqerise nga 'Ujesjelles Himare' SH.A. ne emertimin e ri 'Ujesjelles-Kanalizime' SH.A. Himare si dhe miratimin e statutit te Shoqerise 'Ujesjelles-Kanalizime'SH.A. Himare.

Bazuar ne ligjin 139/2015.dt.17.12.2015 'Per veteqeverisjen vendore',neni 9 pika 1.1/a dhe 1.1/b ,neni 23,neni 54 pika d dhe k,ne ligjin9901 dt.14.04.2008 'Per tregetaret dhe shoqerite tregetare',ligji nr.115 dt.31.07.2014 'Per ndarjen administrativo-terrtoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise',V.K.M. nr.63 dt.27.01.2016.'Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujerave te ndotura',statutit te shoqerise si dhe projekt-vendimit te paraqitur nga Bashkia Himare per miratimin e ndryshimit te emrit te Shoqerise nga 'Ujesjelles Himare' SH.A. ne emertimin e ri 'Ujesjelles-Kanalizime'SH.A.Himare si dhe miratimi e statutit te Shoqerise 'Ujesjelles-Kanalizime' SH.A. Himare Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij date 28.12.2016;

VENDOSI

1-Miratimin e ndryshimit te emrit te Shoqerise mga 'Ujesjelles Himare'SH.A. ne emertimin e ri 'Ujesjelles-Kanalizime'SH.A.Himare.

2-Miratimin e statutit te Shoqerise 'Ujesjelles-Kanalizime' SH.A. Himare [bashkangjitur ketij vendimi]

3-Per ndjekjen e procedurave te metejshme dhe regjstrimin ne Q.K.B. ngarkohet Kryetari I Bashkise,Administratori i shoqerise 'Ujesjelles-Kanalizime'SH.A. ose personi i autorizuar prej tij.

4-Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit 139/2015.dt.17.12.2015 'Per veteqeverisjen vendore' neni 55,pika 6.

Sekretari
Thodhori Beja

Kryetari
Foto Karavella

AKT I THEMELIMIT
TE SHOQËRISË ANONIME
" UJESJELLSI HIMARE" SHA

Neni 1

Emërtimi I shoqerise

Keshilli i Bashkise Himare ne Mbledhjen e dates 16.Dhjetor 2011 miratoi procedurat e themelimit e Shoqërise "Ujësjellësi Himare" sha. Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008" Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë është në Spile-Himare. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarise

Kohëzgjatja e veprimtarise është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve.

Neni 4

Objekti

Objekti i shoqërisë është:

1. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
2. Mirëmbajtjen e sistemit(eve) të furnizimit me ujë të pijshëm;
3. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
4. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij;
5. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 5

Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 39.544.380 leke dhe eshte ndare ne 39.544,38 aksione me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht dhe perbehet nga vlera e aktiveve te qendrueshme te trupzuara ne shumen prej 37.544.380 leke dhe 2.000.000 leke kontribut ne cash .

Neni 6

Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
3. Aksionet zotërohen në masën 100% nga Bashkia Himare si përfaqësuese e pronarit shtet.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të sh.a.Ujësjellësi Himare janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës
2. Drejtori i Përgjithshëm

Neni 8

Këshilli Mbikëqyrës

Keshilli Mbikqyres i shoqerise "Ujesjellesi Himare"sha perbehet nga :

1. Viron Zoto
2. Petro Dhima
3. Andrea Aleksi

Emerimi i antareve te Keshillit Mbikqyres do te kryhet sipas procedurave ligjore nga aksonieri i shoqerise.Me mbarimin e këtij afati, aksionari, që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, nëse nuk e ka përcaktuar emrin e tij në mbledhjen e asamblesë, i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë, si dhe organeve përkatëse që mbajnë regjistrin tregtar njoftim me emrin e anëtarit që do të caktohet në Këshillin Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, njofton aksionarin që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, 1 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të caktuar me rotacion.

Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këtë nen, është i pavlefshëm.

Neni 9

Dispozita të përgjithshme

E gjithe veprimtaria e shoqerise " Ujesjellesit Himare" sha do te bazohet ne zbatim te Ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e organeve te Qeverisje Vendore",neni 32 germa d, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",VKM Nr.271,date 08.05.1998 "Per miratimin e statutut TIP te Shoqerive Anonime Shteterore",VKM Nr 678 ,date 03.10.2007 "Per nje shtese ne VKM Nr. 271,date 08.05.1998 "Per miratimin e statutut TIP te Shoqerive Anonime Shteterore"

Neni 10

Ky Akti Themelimi u miratua me Vendimit te Keshillit te Bashkise Himare Nr 05 date 29/07/2011 "Mbi themelimin e shoqerise aksionere "Ujesjellesi Himare " sha, Vendimit te Keshillit te Bashkise Himare Nr.17 date 23/09/2011 " Per emerimin e antareve te Keshillit Mbikqyres", Vendimit te Keshillit te Bashkise Himare Nr 39, date 116/12/2011 " Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise aksionere "Ujesjellsi Himare" sha dhe u nenshkrua ne 5 kopje sot me daten 26 Dhjetor 2011

Himare 26 Dhjetor 2011

Per Aksionerin e Shoqerise "Ujesjellesit Himare"sha
Stefan KOKEDHIMA

Stefan Kokedhima

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA HIMARE

ACCORD CONCERNANT MONACO ET LA FRANCE
ET LA BELGIQUE ET LA LUXEMBOURG ORIGINAL

Tome I

Instrument 1.01

Monaco, Bruxelles, Paris, Luxembourg, 1 et 2 et 4 octobre 1963 (Annexe 1, partie 1)

Monaco, Bruxelles, Paris, Luxembourg, 1 et 2 et 4 octobre 1963 (Annexe 1, partie 2)

Monaco, Bruxelles, Paris, Luxembourg, 1 et 2 et 4 octobre 1963 (Annexe 1, partie 3)

Monaco, Bruxelles, Paris, Luxembourg, 1 et 2 et 4 octobre 1963 (Annexe 1, partie